

# **“Ndezur është kjo gjëja?” Gafa të udhëheqësve botërorë, me mikrofonin hapur**

Nga Brioni Xhons dhe Tim Hjume

Në hapësirën e vetëm një dite, dy njerëzit më të pushtetshëm të Britanisë - Mbretëresha Elisabetë II dhe Kryeministri David Cameron - janë vetëdijësuar publikisht për rreziqet e një mikrofonit të ndezur.

Cameron ishte i pari, kur fjalët e tij të sinqerta drejtuar Mbretëreshës për Nigerinë dhe Afganistanin - duke i quajtur “tmerrësisht të korrupsuar” dhe “ndoshta dy

prej vendeve më të korrumpuar në botë” - u kapën në kamera.

Komentet shkaktuan një stuhi të vërtetë në internet, si dhe një reagim të fortë nga zëdhënësi i residentit nigerian, i cili tha se ato ishin “të turpshme”.

Menjëherë më pas, u shfaqën pamje të Mbretëreshës, që i thoshte një zyrtari të Policisë Metropolitane se zyrtarët kinezë kishin qenë shumë “të pasjellshëm” gjatë vizitës së parë shtetërore të presidentit Xi Jinping në Britani vitin e kaluar - ndoshta duke i ndërlikuar kështu marrëdhëniet me superfuqinë.

Për njerëzit e mësuar të jetojnë nën blicet e medias, është e habitshme se sa shpesh udhëheqësit botërorë harrojnë rregullin e artë të transmetimeve: Gjithmonë mendo që mikrofonit është ndezur.

Ja disa prej rasteve më të paharrueshme, kur gjërat kanë shkuar keq:

1. Obama, Sarkozy flasin keq për Netanjahun  
Presidenti Barak Obama, si dhe homologu i tij i atëhershëm francez, Nikolas Sarkozy, u gjend nën zjarrin e kritikave në nëntor 2011, pasi u dëgjuan tek flisnin për Kryeministrin izraelit, Benjamin Netanjahu në samitin e G20-ës. Sarkozy i tha Obamës: “Nuk e duroj dot, është gënjeshtar”, sipas faqes së internetit Arret sur Images. Thuhet se Obama u përgjigj: “Je lodhur prej tij; pa më pyet mua? Mua më duhet të merrem me të përditë”.

2. Gordon Braun për votuesen fanatike

Fushata e Kryeministrit të atëhershëm britanik, Gordon Braun nuk po shkonte shumë mirë, por ai as e kishte idenë se sa do të përkeqësohej, kur të ndalej dhe të bisedonte me një votuese në Rochdale, Angli, një javë para zgjedhjeve. Xhillian Dafi, një pensioniste 66-vjeçare e qortoi Braunin, duke shpjegaur përse - pavarësisht se kishte mbështetur laburistët e tij gjithë jetën - tani kishte turp të pranonte përkatësinë politike. Brauni vazhdoi me një bashkëbisedim të sjellshëm me të para kamerave, më pas u largua, pa e ditur që mikrofonin e kishte ende ndezur. Kur hyri në makinë, ai iu ankua këshilltarëve: “Kjo ishte katastrofë. Nuk duhej të më kishin vënë kurrë me atë grua... Qesharake... grua fanatike”. Më pas Brauni kërkoi ndjesë, por i humbi zgjedhjet.

### 3. Xhorxh Bush dhe Toni Bler

Paraardhësi i Braunit, Toni Bler ishte dëshmitar i një prej gafave më të mëdha me mikrofonin ndezur nga presidenti Bush, gjatë një dreke pune në samitin e G8-ës në Rusi. Bushi e përshëndeti Kryeministrin duke thirrur “Yo Blair!” dhe e falënderoi për një pulovër, që Bleri ia kishte dërguar së fundmi si dhuratë. Më pas, ai nisi të diskutojë për situatën në Lindjen e Mesme, duke ofruar një zgjidhje jo dhe aq diplomatike për vështirësitë mes Sirisë dhe Izraelit. “Ajo që duhet të bëjnë”, i tha ai Blerit, “është ta detyrojnë Sirinë që të detyrojë Hezbollahun t’i japë fund këtij m..., dhe kështu e gjitha merr efund”.

#### 4. Bushi për një gazetar

Presidenti i 43 i SHBA i kishte zakon gafat - për “Bushizmat” e tij të famshme janë shkruajtur libra të tërë - dhe ato u shfaqën edhe gjatë fushatës. Në një ndalesë në Illinois në vitin 2000, Bushi u kap nga kamerat duke e quajtur Adam Klajmerin e Nju Jork Tajms një “trap të madh”, dhe Dik Çenej iu përgjigj atypëraty: “Oh po, shumë i madh”.

Më pas Bushi tha se i vinte keq që komentete tij ishin dëgjuar. “Më vjen keq që komentet private u shfaqën në televizione”, tha ai. “Më vjen keq që njerëzit i dëgjuan”.

#### 5. Princi Çarls për korrespondentin e Familjes Mbretërore

Bushi nuk është e vetmja figurë publike që ka shprehur zemërim dhe irritim ndaj mediave në një moment kur e kanë kapur pa dashje kamerat. Princi Çarls u kap nga media britanike teksa pëshpëriste për një gazetar, me të bijtë, Uilliam dhe Herri, gjatë një seance fotografish kur ndodheshin me pushime për ski në Zvicër.

“Nuk e duroj dot atë njeri. Është i tmerrshëm, vërtetë i tmerrshëm”, tha ai për Nikolas Uitçuell, korrespondent i BBC për familjen mbretërore. Komenti ndihmoi shumë pak për të rregulluar marrëdhënien e tij me median, dhe vërtetoi që gafat sërish mund të ofendojnë, edhe kur thuhet me gjuhë të sjellshme.

6. Xho Bajden dhe Obama

Zëvendës presidenti i SHBA, Xho Bajden është në një nivel vërtetë më vete. Në një prej gafave të tij më të famshme, ai u kap në kamera duke përdorur fjalën Fuck teksa përgëzonte obamën për firmosjen e një ligji të shumë diskutuar për ribërjen totale të kujdesit shëndetësor, në mars 2010. Duke ia prezantuar presidentin mediave, ai u kthye të përqafojë Obamën, duke pëshpëritur: “This is a big fucking deal”.

7. Xhon Mejxhër për kolegët... dhe vetveten

Zgjedhjet janë gjithmonë një terren pjellor për gafa, teksa politikanët luftojnë për kohë televizive dhe tituj gazetash, por kryeministri i atëhershëm i Britanisë së Madhe, Xhon Mejxhër u gjend në telashe në vitin 1993,



kur pranoi se nuk e kuptonte përse njerëzit vazhdonin ta votonin.

Një ditë pasi pjesëtarët e Partisë së tij Konservatore ishin rebeluar në Parlament, për shkak të planeve për zgjerimin e lidhjeve të Britanisë me Europën, Mejxhër që zakonisht ishte shumë i rezervuar, u dëgjua tek i quante “bastardë” ligjvënësit euroskeptikë, dhe kanosej që t’i “kryqëzonte”. Duke folur me një gazetar pas një interviste - kur mendonte se mikrofoni ishte fikur - Mejxhëri tha se “nuk e kuptoj përse një burracak si unë vazhdon të fitojë”.

Zhak Shirak për ushqimin britanik

Presidenti i Francës, Zhak Shirak gjithashtu është kapur pa dashje nga kamerat, duke kritikuar një komb

të tërë. Shiraku po luante një rol udhëheqës në përpjekjet e Parisit për të organizuar Olimpiadën e vitit 2012, kur u përpoq të bënte maksimumin me atë që e shihte si avantazh të qartë ndaj konkurrentit britanik: ushqimin. “E vetmja gjë që ata kanë bërë ndonjëherë për bujqësinë europiane, është sëmundja e lopës së çmendur”, i tha ai presidentit rus, Vladimir Putin dhe kancelarit të atëhershëm të Gjermanisë, Gerhard Schröder. “Nuk mund t’u besosh njerëzve që kanë kuzhinë kaq të keqe”. Komentet provokuan zemërimin e tabloidëve britanikë, por ata që qeshën të fundit ishin pikërisht britanikët, pasi fituan të drejtën për organizimin e Olimpiadës.

Ronald Regan për Rusinë

Një shaka e presidentit Ronald Regan në kulmin e Luftës së Ftohtë mund të kish patur pasoja vërtetë serioze. Duke marrë pjesë në një kontroll të zërit pak përpara fjalimit të përjavshëm radiofonik në gusht 1984, Regani u tha dëgjuesve: “Bashkatdhetarët e mi amerikanë, jam i kënaqur t’ju shpall sot se kam firmosur ligje që e nxjerrin Rusinë të paligjshme, një herë e përgjithmonë”.

CNN - Në shqip nga [www.bota.al](http://www.bota.al)